



Financuar nga
Bashkimi Evropian

EURALIUS
Consolidation of the
Justice System in Albania

Heqje dorë nga përgjegjësia:

Jeni të lutur të vini re se ky dokument përbën një përkthim jozyrtar të destinuar vetëm për qëllime informimi. Teksti nuk jep asnjë të drejtë dhe nuk imponon asnjë detyrim të ndryshëm nga çfarë parashikohet në legjislacionin e miratuar dhe të botuar në Fletoren Zyrtare. EURALIUS nuk garanton saktësinë dhe nuk mban përgjegjësi për përdorimin që mund t'i bëhet informacionit të mëposhtëm.

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Vendim Nr.276 datë 10.12.2019

PËR MIRATIMIN E "PROGRAMI I VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQARËVE PËR VITIN 2020"

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenin 147 pika 1 shkronja "a" të Kushtetutës, në nenet 2, 68-72, 74-78, 84-95, 97 dhe 171 të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në vendimet e KLGJ-së nr. 263 datë 21.11.2019 "Rregullat plotësuese të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve" dhe nr. 264 datë 21.11.2019, "Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit", me propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

VENDOSI:

1. Miratimin e "Programi i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2020", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të Këshillit.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

Ministria e Drejtësisë,
Bulevardi "Zogu I"
Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 22 40 333
E-mail: info@euralius.eu
Web: www.euralius.eu



PROGRAMI I VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARËVE PËR VITIN 2020

Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ), bazuar në 85/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, brenda muajit nëntor të çdo viti, duhet të miratojë programin me listën e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, për të cilët do të kryhet vlerësimi etik dhe profesional përgjatë vitit pasardhës, bashkë me përcaktimin e periudhës së vlerësimit. Qëllimi i këtij programi është përgatitja paraprakisht e një plani pune me emrat e gjyqtarëve që do të vlerësohen përgjatë vitit 2020, por nuk nënkupton fillimin e procesit të vlerësimit. Miratimi i këtij programi iu shërben gjithashtu Kryetarëve e Kancelarëve të gjykatave, që të organizojnë punën për plotësimin e tabelave statistikore e dërgimin e tyre në KLGJ, brenda muajit janar, para se të fillojë procesi i vlerësimit për secilin gjyqtar të përfshirë në këtë listë.

Me vendimin nr.263 dt. 21.11.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147 pika 1 shkronja “a” të Kushtetutës, si dhe në nenet 2, 68-72, 74-78, 84-95, 97 dhe 171 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 25 të ligjit 48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 96/2016”, ka miratuar rregullat plotësuese të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve, ndërsa me vendimin nr.264 dt.21.11.2019, ka miratuar metodologjinë e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit. Këto dy akte nënligjore kanë hyrë në fuqi në dt. 27.11.2019, pas botimit në fletoren zyrtare Nr. 159 të vitit 2019.

Bazuar ne ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe dy vendimet nr. 263 dt. 21.11.2019 dhe nr. 264 dt. 21.11.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor, harton këtë program për të gjithë gjyqtarët që do të vlerësohen gjatë vitit 2020.

Ky program vlerësimi përmban listën e gjyqtarëve që do të vlerësohen përgjatë vitit 2020 si dhe periudhën e vlerësimit përkatëse.

Në lidhje me gjyqtarët që vlerësohen dhe periudhën e tyre të vlerësimit, programi i vlerësimeve përmban :

- 1) Gradimin e gjyqtarëve, të konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë nga organet e rivlerësimit, në vijim të procesit të vlerësimit për periudhën e vlerësimit 2013-2016, e cila përkon me periudhën 3/vjeçare të rivlerësimit kalimtar;
- 2) Vlerësimin normal të gjyqtarëve me jo më pak se 3/vjet dhe jo më shumë se 15/vjet përvojë profesionale në dt. 01.01.2017, për periudhën e vlerësimit 2017-2019;
- 3) Vlerësim të përshpejtuar të detyruar për periudhën e vlerësimit 01.01.2019-31.12.2019, sipas një programi të veçantë që Këshilli do të miratojë në rastet kur kërkohet nga gjyqtari, ngritja në detyrë ose lëvizja paralele.

Pjesë e këtij programi vlerësimi, nuk janë kryetarët e gjykatave, sepse aktualisht pjesa me e madhe e gjykatave drejtohen nga zëvendëskryetarët. Një numër i konsiderueshëm i kryetarëve të gjykatave janë shkarkuar gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar dhe pjesa tjetër është në këtë proces. Veç kësaj rrethane, rregullat plotësuese të vlerësimit të veprimtarisë së Kryetarëve nuk janë miratuar ende nga Këshilli.

Përcaktimi i listës me kryetarët e gjykatave që do të vlerësohen, mbetet një nga prioritetet e ardhshme të programit të vlerësimit.

Lista e gjyqtarëve që do të vlerësohen gjatë vitit 2020, është përpiluar mbi prioritetet e mëposhtme:

Së pari, bazuar në nenin 171/5 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe neneve 21/1 dhe 23/a të vendimit nr. 263, dt 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve”, janë përfshirë në listë, për të përcaktuar gradën/nivelin e vlerësimit përkatës, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, gjyqtarët të cilët kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar me vendim të formës së prerë.

Kjo listë përfshin gjyqtarët :

LISTA I

Nr	Gjyqtar	Gjykata	Vendimi	data	Fillimi i detyres
1.	Manjola Xhaxho	Gj. Rr. Tiranë	nr.19	14.5.2018	21.10.2002
2.	Nertina Kosova	Gj.Ap. Krime	nr. 43	18.7.2018	30.05.1998
3.	Gentian Medja	Gj.Adm.Tiranë	nr.60	1.8.2018	17.09.2004
4.	Enton Dhimitri	Gj.Ap. Gjirokastër	nr.79	22.11.2018	17.09.2004
5.	Emona Muçi	Gj.Rr. Pogradec	nr.85	13.12.2018	10.10.2012
6.	Eriol Roshi	Gj.Adm.Tiranë	nr.104	7.2.2019	03.10.2005
7.	Ornela Naqellari	Gj.Rr. Lezhë	nr.117	21.3.2019	07.01.2009
8.	Albana Boksi	Gj.Ap. Krime	nr.135	5.4.2019	15.09.2000
9.	Esmeralda Çeka (Xhili)	Gj.Rr. Lushnje	nr.141	18.4.2019	05.10.2007
10.	Rexhep Bektashi	Gj.Rr. Durrës	nr.143	26.4.2019	12.11.1993
11.	Sokol Binaj	Gj.Ap. Krime	nr.149	20.5.2019	15.08.1985-16.11.1990 20.02.2004
12.	Dhimitër Lara	Gj.Ap. Krime	nr.158	29.5.2019	01.10.1999
13.	Margarita Buhali	Gj.Ap. Vlorë	nr.164	19.6.2019	01.10.2001

14.	Klodiana Mema (Veizi)	Gj.Adm.Durrës	nr.165	21.6.2019	17.09.2004
15.	Saida Dollani	Gj.Ap. Krime	nr.167	26.6.2019	24.11.1993

Këshilli do të përfshijë në këtë listë gjatë planifikimeve 3/mujore të fillimit të procesit të rivlerësimit, edhe gjyqtarët, të cilët gjatë vitit 2020, kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar me vendim të formës së prerë.

Në këtë listë Këshilli vlerëson të mos përfshijë ;

a) Gjyqtarët të cilët janë anëtarë të tij, e konkretisht; 1. Gjyqtari Medi Bici, 2. Gjyqtari Ilir Toska, 3. Gjyqtarja Brikena Ukperaj, 4. Gjyqtari Dritan Hallunaj, 5. Gjyqtarja Marçela Shehu dhe 6. Gjyqtarja Brunilda Kadi. Arsyeja e mospërfshirjes së këtyre gjyqtarëve në këtë listë, lidhet me faktin se vlerësimi i anëtarëve aktualë të KLGJ-së nga vetë ky Këshill, do t' i vendoste ata në një pozicion jo të përshtatshëm përsa i përket perceptimit të publikut dhe gjyqtarëve të tjerë.

b) Gjyqtarin Ardian Dvorani, anëtar i Gjykatës së Lartë. Arsyeja e mospërfshirjes së këtij gjyqtari në listë lidhet me faktin se gjatë periudhës së vlerësimit për të cilën bëhet gradimi, e cila përputhet me periudhën e rivlerësimit kalimtar, anëtar i Gjykatës së Lartë nuk ka qenë subjekt i vlerësimit etik dhe profesional. Legjislacioni i mëparshëm nuk parashikonte vlerësim etik dhe profesional për anëtarët e Gjykatës së Lartë.

Së dyti, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, bazuar në nenin 84 dhe 171/5 të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenin 21/2 të vendimit nr. 263, dt 21.11.2019 "Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve", janë përfshirë në listën e gjyqtarëve që do të vlerësohen në vitin 2020, vetëm ata gjyqtarë që kanë pasur në dt. 01 Janar 2017, jo më pak se 3 vjet dhe jo më shumë se 15 vjet përvojë profesionale.

Arsyeja e këtij kufizimi është e lidhur me përcaktimet e nenit 84 pika 1 dhe 2 të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, sipas të cilit : *"...gjyqtarët vlerësohen një herë në tre vjet, gjatë pesëmbëdhjetë viteve të para të përvojës profesionale, përfshirë edhe përvojën profesionale si ndihmësmagjistrat ose magjistrat i komanduar, dhe një herë në pesë vjet, pas 15 viteve të para të përvojës profesionale si magjistrat"*.

Në kushtet kur periudha e vlerësimit që përmban ky program, është 3/vjeçare dhe përfshin vitet kalendarikë 2017, 2018, 2019, në këtë listë nuk mund të përfshihen gjyqtarët që kanë pasur mbi 15 vjet përvojë profesionale në dt. 01 Janar 2017, pasi për këta gjyqtarë periudha e vlerësimit duhet të jetë 5 vjeçare. Vlerësimi i këtyre të fundit, sipas përcaktimit ligjor të nenit 84/1 të ligjit 96/2016, fillon në vitin 2022.

Kjo listë përfshin gjyqtarët :

Lista II

Nr	Gjyqtar	Gjykata	Fillimi i detyrës	Vite Pune ne dt. 01.01.2017
1.	Adelajda Gjuzi	Gj. Rr. Berat	10.10.2012	4 vite e 2 muaj
2.	Diamela Goxha	Gj.Rr.Berat	10.10.2012	4 vite e 2 muaj
3.	Lutfije Celami	Gj.Rr.Berat	10.11.2011	5 vite e 1 muaj
4.	Matilda Llangozi	Gj.Rr. Berat	10.11.2011	5 vite e 1 muaj
5.	Rudina Palloj	Gj.Rr.Berat	10.11.2011	5 vite e 1 muaj
6.	Edvan Velçani	Gj.Rr. Dibër	10.11.2011	5 vite e 1 muaj
7.	Gilda Llambraj	Gj.Rr. Dibër	10.11.2011	5 vite e 1 muaj
8.	Mimoza Margjeka	Gj.Rr.Durrës	16.12.2004	12 vite
9.	Petraç Çurri	Gj.Rr.Durrës	22.06.1992- 23.01.1993 05.04.2010	7 vite e 6 muaj
10.	Enkelejda Kapedani	Gj.Rr.Elbasan	21.10.2013	3 vite e 2 muaj
11.	Arta Burda	Gj.Rr.Fier	27.09.2010	6 vite e 3 muaj
12.	Ejona Lazellari	Gj.Rr.Fier	21.10.2013	3 vite e 2 muaj
13.	Igerta Bengu	Gj.Rr.Fier	27.09.2010	6 vite e 3 muaj
14.	Marsela Dervishi	Gj.Rr.Fier	10.10.2012	4 vite e 2 muaj
15.	MatildaShalla	Gj.Rr.Fier	05.10.2007	9 vite e 2 muaj
16.	OlkedaLiçe	Gj.Rr.Fier	10.11.2011	5 vite e 1 muaj
17.	Taulant Banushi	Gj.Rr.Fier	21.10.2003	13 vite e 2 muaj
18.	Arben Dosti	Gj.Rr.Gjirokastrë	21.10.2013	3 vite e 2 muaj
19.	Ariola Kristo	Gj.Rr.Korçë	21.10.2002	14 vite e 2 muaj
20.	Flojera Davidhi	Gj.Rr.Korçë	21.10.2013	3 vite e 2 muaj
21.	Genti Dokollari	Gj.Rr.Korçë	21.10.2013	3 vite e 2 muaj
22.	Sonjela Voskopi	Gj.Rr.Korçë	05.10.2007	9 vite e 2 muaj
23.	Alma Kolgjoka Hoxha	Gj.Rr.Krujë	05.10.2007	9 vite e 2 muaj
24.	Engjëllushe Tahiri	Gj.Rr.Krujë	07.01.2009	8 vite
25.	Enkelejda Hoxha	Gj.Rr.Krujë	21.10.2003	13 vite e 2 muaj
26.	Alma Ahmeti Zhupa	Gj.Rr.Kukës	07.01.2009	8 vite
27.	Aurel Arapi	Gj.Rr.Kurbin	21.10.2013	3 vite e 2 muaj
28.	Artan Hajredinaj	Gj.Rr.Lezhë	20.03.2007	9 vite e 9 muaj
29.	Elsa Ulliri	Gj.Rr.Lezhë	21.10.2013	3 vite e 2 muaj
30.	Ornela Naqellari	Gj.Rr.Lezhë	07.01.2009	8 vite
31.	Esmeralda Çeka (Xhilli)	Gj.Rr.Lushnje	05.10.2007	9 vite e 2 muaj
32.	Zeta Terpollari	Gj.Rr.Lushnje	07.01.2009	8 vite
33.	Dritan Hasani	Gj.Rr.Përmet	10.10.2012	4 vite e 2 muaj

34.	Rezarta Aliu Paja	Gj.Rr.Përmet	07.01.2009	8 vite
35.	Emona Muçi	Gj.Rr.Pogradec	10.10.2012	4 vite e 2 muaj
36.	Luljeta Topalli Kolonja	Gj.Rr.Pogradec	21.10.2002	14 vite e 2 muaj
37.	Enkeleda Doda	Gj.Rr.Sarandë	21.10.2002	14 vite e 2 muaj
38.	Sokol Pina	Gj.Rr.Sarandë	21.10.2013	3 vite e 2 muaj
39.	Andri Ymeri	Gj.Rr.Shkodër	21.10.2003	13 vite e 2 muaj
40.	Arbër Çela	Gj.Rr.Shkodër	27.09.2010	6 vite e 3 muaj
41.	Irida Kaçerja	Gj.Rr.Shkodër	05.10.2007	9 vite e 2 muaj
42.	Luveda Dardha	Gj.Rr.Shkodër	10.10.2012	4 vite e 2 muaj
43.	Sokol Shehu	Gj.Rr.Shkodër	10.11.2011	5 vite e 1 muaj
44.	Alma Kodraliu	Gj.Rr.Tiranë	07.01.2009	8 vite
45.	Anila Karanxha	Gj.Rr.Tiranë	03.10.2005	11 vite e 2 muaj
46.	Antonela Prendi	Gj.Rr.Tiranë	16.09.2004	12 vite e 3 muaj
47.	Arjan Aliaj	Gj.Rr.Tiranë	21.12.2009	7 vite
48.	Ahmet Metaliaj	Gj.Rr.Tiranë	08.02.1996- 25.05.1999 21.11.2016	3 vjet e 4 muaj
49.	Erjon Bani	Gj.Rr.Tiranë	10.10.2012	4 vite e 2 muaj
50.	Ervin Pollozhani	Gj.Rr.Tiranë	03.10.2005	11 vite e 2 muaj
51.	Gerd Hoxha	Gj.Rr.Tiranë	21.10.2002	14 vite e 2 muaj
52.	Irena Plaku	Gj.Rr.Tiranë	27.09.2010	6 vite e 3 muaj
53.	Irena Hoxha	Gj.Rr.Tiranë	18.02.2004	12 vite e 10 muaj
54.	Juljan Haxhiu	Gj.Rr.Tiranë	21.10.2002	14 vite e 2 muaj
55.	Klorinda Çela	Gj.Rr.Tiranë	17.09.2004	12 vite e 3 muaj
56.	Kastriot Gramshi	Gj.Rr.Tiranë	04.09.1999- 27.09.2004 10.07.2014	7 vite e 5 muaj
57.	Lazër Sallaku	Gj.Rr.Tiranë	17.12.2007- 05.04.2010 05.04.2010	9 vite e 8 muaj
58.	Marinela Nuni Osmani	Gj.Rr.Tiranë	16.09.2004	12 vite e 3 muaj
59.	Manjola Xhaxho	Gj.Rr.Tiranë	21.10.2002	14 vite e 2 muaj
60.	Migena Laska	Gj.Rr.Tiranë	04.10.2006	10 vite e 2 muaj
61.	Neritan Cena	Gj.Rr.Tiranë	17.09.2004	12 vite e 3 muaj
62.	Tereza Merkaj Lani	Gj.Rr.Tiranë	21.10.2003	13 vite e 2 muaj
63.	Vjosa Zaimi Çela	Gj.Rr.Tiranë	21.10.2002	14 vite e 2 muaj
64.	Sokol Pasho	Gj.Rr.Tiranë	30.08.1996- 19.09.2000 07.03.2016	4 vite e 9 muaj

65.	Erjon Çela	Gj.Rr.Tropojë	10.11.2011	5 vite e 1 muaj
			01.07.1992- 08.05.1993 21.12.2010	7 vite
66.	Sami Ujkashi	Gj.Rr.Tropojë		
67.	Arbana Selmanaj	Gj.Rr.Vlorë	04.10.2006	10 vite e 2 muaj
68.	Atalanta Zeqiraj	Gj.Rr.Vlorë	21.10.2013	3 vite e 2 muaj
69.	Elona Mihali	Gj.Rr.Vlorë	10.10.2012	4 vite e 2 muaj
70.	Ervin Trashë	Gj.Rr.Vlorë	05.10.2007	9 vite e 2 muaj
71.	Laurent Fuçia	Gj.Rr.Vlorë	27.09.2010	6 vite e 3 muaj
			23.08.1996- 25.05.1999 24.11.2011	8 vite e 1 muaj
72.	Skënder Haluca	Gj.Rr.Vlorë		
73.	Vjola Canaj	Gj.Rr.Vlorë	03.10.2005	11 vite e 2 muaj
74.	Bib Ndreca	Gj.Kr.Rënda	07.01.2009	8 vite
75.	Daniela Shirka	Gj.Kr.Rënda	21.10.2003	13 vite e 2 muaj
			04.09.1999- 02.12.2009	10 vite e 3 muaj
76.	Marsela Balili	Gj.Kr.Rënda		
77.	Klodiana Mema (Veizi)	Gj.Adm.Durrës	17.09.2004	12 vite e 3 muaj
78.	Elidon Papazisi	Gj.Adm.Gjirokastër	03.10.2005	11 vite e 2 muaj
			01.07.1994- 11.07.1998 24.11.2010	10 vite e 1 muaj
79.	Ramiz Lala	Gj.Adm.Gjirokastër		
80.	Sokol Ibi	Gj.Adm.Korçë	04.10.2006	10 vite e 2 muaj
81.	Afërdita Maho	Gj.Adm.Tiranë	21.10.2003	13 vite e 2 muaj
82.	Arbena Ahmeti	Gj.Adm.Tiranë	04.10.2006	10 vite e 2 muaj
83.	Bezart Kaçkini	Gj.Adm.Tiranë	04.10.2006	10 vite e 2 muaj
84.	Elda Vrioni	Gj.Adm.Tiranë	21.10.2002	14 vite e 2 muaj
85.	Elvana Çiçolli	Gj.Adm.Tiranë	04.10.2006	10 vite e 2 muaj
86.	Emiljano Ruli	Gj.Adm.Tiranë	03.10.2005	11 vite e 2 muaj
87.	Enerjeta Deraj Shehaj	Gj.Adm.Tiranë	05.10.2007	9 vite e 2 muaj
88.	Erarbër Madhi	Gj.Adm.Tiranë	17.09.2004	12 vite e 3 muaj
89.	Eriol Roshi	Gj.Adm.Tiranë	03.10.2005	11 vite e 2 muaj
90.	Gentian Hamiti	Gj.Adm.Tiranë	05.10.2007	9 vite e 2 muaj
91.	Gentian Medja	Gj.Adm.Tiranë	17.09.2004	12 vite e 3 muaj
92.	Selvie Gjoçaj	Gj.Adm.Tiranë	04.10.2006	10 vite e 2 muaj
93.	Gentiana Xhelili	Gj.Adm.Vlorë	07.01.2009	8 vite
94.	Ken Dhima	Gj.Adm.Vlorë	21.10.2003	13 vite e 2 muaj
95.	Altina Nasufi	Gj.Ap.Adm.Tiranë	21.10.2002	14 vite e 2 muaj
96.	Bernina Kondi	Gj.Ap.Adm.Tiranë	21.10.2003	13 vite e 2 muaj

97.	Anita Mici	Gj.Ap.Durrës	17.09.2004	12 vite e 3 muaj
98.	Desart Avdulaj	Gj.Ap.Durrës	21.10.2003	13 vite e 2 muaj
99.	Aleks Nikolli	Gj.Ap.Shkodër	21.10.2003	13 vite e 2 muaj
100.	Vojsava Osmanaj	Gj.Ap.Shkodër	05.10.2007	9 vite e 2 muaj
101.	Andi Civici	Gj.Ap.Tiranë	21.10.2002	14 vite e 2 muaj
102.	Asim Vokshi	Gj.Ap.Tiranë	03.10.2005	11 vite e 2 muaj
103.	Elbana Lluri	Gj.Ap.Tiranë	17.09.2004	12 vite e 3 muaj
104.	Fatmira Hajdari	Gj.Ap.Tiranë	31.10.2003	13 vite e 2 muaj
105.	Fatri Islamaj	Gj.Ap.Tiranë	03.10.2005	11 vite e 2 muaj
106.	Enton Dhimitri	Gj.Ap.Gjirokastër	17.09.2004	12 vite e 3 muaj

Në listën e mësipërme nuk janë përfshirë gjyqtarët të cilët në dt. 01 Janar 2017 nuk kishin plotësuar 3 vite përvojë profesionale. Në kushtet kur programet e vlerësimit janë 1/vjecare, këta gjyqtarë do të përfshihen në programin e vlerësimit të viteve pasardhëse.

Në këtë listë nuk është përfshirë Gjyqtarja Rezarta Mataj, e cila ushtron detyrën e gjyqtarit nga data 05.10.2007, aktualisht gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me vendimin nr. 45, dt 22.09.2017 të ish/KLD, asaj i është dhënë leje prindërore e papaguar deri në dt. 06.08.2020. Në këto kushte, bazuar në nenin 5 pika 4 të vendimit nr. 263 dt 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve”, kjo gjyqtare nuk mund të vlerësohet për periudhën 01 Janar 2017 - 31 Dhjetor 2019, pasi gjatë kësaj periudhë ajo ka ushtruar detyrën për më pak se një vit.

Në lidhje me planifikimet 3/mujore të fillimit të procesit të vlerësimit në nenin 11 pika 1 të vendimit nr. 263, dt 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve”, është përcaktuar se : *“Këshilli miraton brenda muajit nëntor të çdo viti, programin vjetor të vlerësimeve etike dhe profesionale. Programi vjetor përmban, për aq sa është e mundur, edhe planifikimin tremujor të vlerësimeve individuale, duke garantuar një organizim efikas të procedurave të vlerësimit si dhe lehtësimin e zhvillimit të shortit.*

Në zbatim të dispozitës së mësipërme, planifikimet 3/mujore të vlerësimeve bëhen pjesë e programit të vlerësimit, për aq sa është e mundur. Duke marrë ne konsideratë faktin që ky është programi i parë i vlerësimeve pas krijimit të KLGJ-së, situatën në të cilën ndodhen gjykatat për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar, vendet vakante që mund të hapen, kërkesat për ngritje në detyrë apo transferim paralel, saktësimin e burimeve njerëzore që do të merren me këtë proces...etj, KLGJ vlerëson që planifikimet 3/mujore të vlerësimeve të miratohen me vendim të veçantë të Keshillit, mbi bazën e të cilit do të fillojë edhe procesi i vlerësimit për secilin gjyqtar.

Por ky program përmban prioritete të planifikimeve 3/mujore të fillimit të procesit të vlerësimit, duke ndjekur këtë radhë;

- 1) gradimin e gjyqtarëve të cilët kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar me vendim të formës së prerë, sipas Listës I, bazuar kjo në nenin 23/a të vendimit nr. 263, dt 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve”;
- 2) kryerjen me përparësi të të gjitha vlerësimeve sipas nenit 22 dhe 23/b të vendimit nr. 263, dt 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve”.
- 3) vlerësimin normal për periudhën 01 Janar 2017 – 31 Dhjetor 2019 të të gjithë gjyqtarëve të Listës II, duke i dhënë përparësi :
 - a) gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar me vendim të formës së prerë, sipas Listës I, por që kanë jo më shumë se 15 vjet përvojë profesionale deri ne datën 01 Janar 2017.
 - b) gjyqtarëve të cilët kanë jo më pak se 7 vjet përvojë profesionale deri në datën 01 Janar 2020, dhe që nuk kanë asnjë vlerësim profesional të mëparshëm. Kriteri për periudhën “*mbi 7 vjet përvojë profesionale*”, lidhet me kriterin e përvojës profesionale për ngritjen në detyrë në gjykatën e apelit. Ndërkohë kriteri “*nuk kanë asnjë vlerësim profesional të mëparshëm*” mundëson vënien, sa më shumë të jetë e mundur, në pozita të barabarta të të gjithë gjyqtarëve.
 - c) gjyqtarët të cilët kanë jo më pak se 7 vjet përvojë profesionale deri ne datën 01 Janar 2020 dhe që kanë një vlerësim profesional të mëparshëm, me qëllim që këtyre gjyqtarëve t’iu mundësohet një vlerësim i dytë real dhe në kohë;
 - d) gjyqtarët të cilët kanë më pak se 7 vjet përvojë profesionale deri në datën 01 Janar 2020 dhe që nuk kanë asnjë vlerësim;
 - e) të gjithë gjyqtarët e tjerë që mbeten nga lista e përgjithshme.

Miratimi i këtij programi ambicioz për KLGJ, sidomos për Komisionin përgjegjës, mbart riskun e mospërfundimit brenda vitit 2020 të të gjitha vlerësimeve, sepse pavarësisht numrit të panjohur deri në këtë moment të gjyqtarëve që do të kandidojnë për lëvizje paralele apo ngritje në detyrë, në kushtet e ecurisë së procesit të rivlerësimit, nevojës për plotësimin e vendeve vakante nëpërmjet lëvizjeve paralele apo ngritjes në detyrë dhe zgjedhjes së kryetarëve të gjykatave, ka gjasa të rritet numri i subjekteve të vlerësimit etik-profesional. Gjithsesi në eventualitetin e mospërfundimit të të gjitha vlerësimeve brenda vitit 2020, ato do të trajtohen me përparësi në vitin pasardhës.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqën zyrtare të Këshillit.

Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale